



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.71/2019
Prishtinë, më 16.7.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Hykmete Bajrami, Lutfi Zharku, Glauk Konjufca, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë dhe Liburn Aliu, anëtar.

I ftuar: **Kreshnik Gashi**, kryetar i Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).

Pjesëmarrës të tjerë: Rrezarta Ajeti – ARKEP; Blerta Bejtullahu – EU/Office; Shpëtim Haziri – GP LDK; Vatra Qehaja – LVV; Marigona Bajrami – PSD; Kushtrim Xhemajli – GP- AAK; Fatlind Azizi – KDI dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, si dhe praktikanti Afrim Berisha.

Mbledhjen e kryesoi, Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 25.6.2019;
3. Votimi i raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), për vitin 2018;
4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2018;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 25.6.2019

Procesverbali i mbledhjes së datës 25.6.2019, u miratua pa vërejte.

3. Votimi i raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), për vitin 2018

Kryetarja theksoi se komisioni e ka shqyrtuar raportin e ZRRE-së, në një nga mbledhjet e kaluara dhe kemi kërkuar raportet e monitorimit shtesë nga ZRRE-ja. Raportet janë dërguar nga ZRRE-ja, siç edhe e kemi parë, prandaj sot do ta votojmë raportin vjetor të ZRRE-së, për vitin 2018, nëse dikush nuk do të shtojë diçka për këto raporte.

Komisioni, me 4 (katër) vota për, 1 (një) kundër dhe 1 (një) abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2018.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2018

Kryetarja theksoi se sot e kemi në shqyrtim raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2018. Kryetarja sqaroi bazën ligjore të raportimit të autoritetit. Ajo potencoi se komisioni, në kuadër të përgjegjësive të tij, ka realizuar vizitë në ARKEP, lidhur me zbatimin e kodit telefonik shtetëror 383, por sot informatat lidhur me kodin mund t'i dëgjojnë deputetët, që nuk kanë mundur të marrin pjesë në vizitë në ARKEP, si dhe pjesëmarrësit tjerë në këtë mbledhje. Për të prezantuar raportin, kryetarja ia dha fjalën kryetarit të Bordit të ARKEP-it, z. Kreshnik Gashi.

Kreshnik Gashi, kryetar i Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), duke prezantuar raportin, theksoi se viti 2018 ka shënuar trend pozitiv të zhvillimit komunikimeve elektronike dhe postare në Republikën e Kosovës, si për nga rritja e vëllimit të trafikut, po ashtu edhe për nga investimet në sektor. Të hyrat e përgjithshme nga shërbimet komunikimeve elektronike për vitin 2018, kanë shënuar ngritje prej 4%. Me gjithë ofrimin e çmimeve konkurrenente për ofrim të shërbimeve, në segmentin më të rëndësishëm të tregut të komunikimeve elektronike, në atë të telefonisë mobile, viti 2018 ka shënuar vitin e parë të trendit pozitiv të rritjes së të hyrave nga ky sektor i tregut, që nga viti 2012 dhe rritje rekorde të shfrytëzimit të teknologjive të reja për përdorim të dhënave 3G dhe 4G. Për më tepër, gjatë këtij viti ka vazhduar të rritet numri i operatorëve që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, me 13 operatorë shtesë, të regjistruar për të ofruar 25 aktivitete të komunikimeve elektronike. Rritja më e madhe e shënuar këtë vit është në segmentin e ofrimit të shërbimeve të internetit, ku në fund të vitit 2018, numri i përdoruesve që shfrytëzojnë shërbimet e internetit përmes qasjes fikse ka arritur në 328,177, shifër kjo që shënon rritje të konsiderueshme të përdoruesve prej 17.5%, në krahasim me vitin e kaluar. Konkurrenca e lartë

në segmentin e ofrimit të shërbimeve të internetit fiks, ka bërë që niveli i penetrimit të këtij shërbimi për familje kosovare të arrijë një rekord prej 110.5% në vitin 2018, që përbën edhe shifrën më të lartë në Evropë për shërbime të internetit fiks për familje. Edhe sektori postar ka shënuar rritje të vëllimit të dërgesave, si dhe gjatë vitit raportues janë regjistruar dy operatorë të rinj për ofrim të këtyre shërbimeve. Vlen të përmendet se miratimi i ligjit të ri për shërbimet postare, në fund të vitit 2018, do të ketë efekt pozitiv në heqjen e barrierave burokratike për sektorin dhe do ta nxisë edhe më tutje zhvillimin e këtij sektori. Sigurisht që, aktivitetet e ARKEP gjatë vitit 2018 u përqendruan kryesisht në arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike për rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, bazuar në strategjinë afatmesme 2018-2020, të miratuar nga ARKEP, e që për qëllim kryesor ka nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në nivel të ofrimit të shërbimeve, si një nga parakushtet thelbësore për nxitjen e investimeve, sigurimin e cilësisë së duhur të shërbimeve me çmime sa më të arsyeshme dhe oferta konkurruese për përdoruesit fundorë (konsumatorët), duke siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave të tyre. Në këtë kuadër, gjatë vitit raportues janë hartuar dhe miratuar një mori aktesh normative, me karakter rregullator dhe me efekte strukturore në tregjet e rregulluara dhe të mbikëqyrura nga autoriteti, detajet për të cilat gjenden në raportin e mëposhtëm. Ky vit ka shënuar edhe fillimin e përgatitjeve për hapje dhe rilicencim të shfrytëzimit të brezeve frekuencore, me rëndësi të posaçme ekonomike, e që përdoren nga operatorët e telefonisë mobile. Është filluar konsultimi publik për hapje për përdorim të brezeve frekuencore 800, 900, 1800, 2100, 2600, dhe 3400- 3800 MHz, që përfshin edhe fillimin e punës për rilicencim të operatorëve aktualë të telefonisë mobile, në njërin anë, proces i cili pritet të përmbyllet gjatë vitit 2019, si edhe hapjen e brezeve të reja frekuencore, që do të mund të përdoren për shfrytëzimin e teknologjisë 4g, por edhe 5g në telefoninë mobile, në anën tjetër. Në kuadër të krijimit të lehtësirave për operatorët e telefonisë mobile për zhvillim të investimeve dhe rritje të kualitetit të shërbimit, këtë vit është bërë rishikimi i rregullores për pagesat vjetore për mbikëqyrje dhe të drejtën e përdorimit të radio frekuencave, me ç’ rast janë zvogëluar tarifat vjetore të mbikëqyrjes në masën prej 30% deri në 40% në varësi nga brezi frekuencor. Në drejtim të internacionalizimit të punës së ARKEP, fundi i vitit 2018 ka rezultuar edhe me ndërrimin e rregullores së Bashkimit Evropian për entin e rregullatorëve të komunikimeve elektronike (BEREC), me ç’ rast Republikës së Kosovës, përkatësisht ARKEP-it i mundësohet për herë të parë të marrë pjesë në të gjitha nivelet e punës së këtij enti, që është organi më i rëndësishëm evropian për fushën e komunikimeve elektronike. Sa i përket zhvillimeve për zbatimin e kodit telefonik shtetëror 383, me gjithë faktin se ARKEP ka kryer të gjitha detyrimet shtetërore në raport me operatorët, procesi i implementimit të plotë të kodit 383 nuk është përmbyllur ende në periudhën raportuese dhe ARKEP është detyruar të gjobisë operatorët e telefonisë, me qëllim të përmbylljes sa më të shpejt të këtij procesi. Në vijim, ky raport ofron një pasqyrë të detajuar të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si dhe të dhënat thelbësore për aktivitetet e rregulluara në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në Republikën e Kosovës. Me gjithë progresin e vazhdueshëm, sfidë mbetet sigurimi i stafit të mjaftueshëm për realizimin e objektivave, si dhe mungesa e pavarësisë financiare, sepse të hyrat nuk kthehen në sektor, por shkojnë në buxhet të e mandej i ndahen ARKEP-it, me ligjin për buxhetin. Në fund, njoftoi se raporti i auditimit për vitin 2018 për ARKEP-in ka dalë pozitiv d.m.th. pa asnjë të gjetur apo rekomandim.

Glauk Konjufca, theksoi se kur e lexojmë raportin, fitohet përshtypja se sektorin e komunikimeve elektronike e kemi të zhvilluar si Zvicra, mirëpo, nëse shikohen faktet, na del

një fotografi ndryshe. Asnjë operator serioz nuk ka shprehur interes të hyjë në tregun e Kosovës. Ka disa operatorë që duan të hyjnë në treg, që prapa tyre qëndrojnë kompani nga Serbia dhe Rusia. Po ashtu, kemi edhe rastin e Telekomit, i cili është në bankrotim, si pasojë e marrëveshjes së dëmshme me Z Mobile. Një shkëlqje në procesin e Telekomit me Z Mobile është bërë nga ARKEP, duke e transferuar licencën nga Dardafone në Dardafone.net. Ju si institucion, a merreni me vetveten, a i analizoni vendimet e juaja? A e keni në institucionin tuaj kontratën mes Telekomit dhe Z Mobile? A është Z Mobile MVNO? MVNO-ja duhet të jetë lehtësues e neve na ka dalë shkatërrues. Ju, si institucion, keni përgjegjësinë kryesore, ju i keni lejuar këto hapësira ligjore me qëllim. Çka mendoni ju për këto çështje? Ju nuk keni bërë ndërhyrje, edhe pse e keni parë që tregu i komunikimeve elektronike nuk është duke u zhvilluar mirë.

Lutfi Zharku pyeti: Pse po marrim ende sms me 377? A ka kërkesa për hyrje në treg të operatorëve të telefonisë mobile? A mendohet të hapet në tërësi tregu i telefonisë mobile, që kushdo që i plotëson kushtet të mund të hyjë në treg, ndërsa Telekomit, ndoshta, do të mbetet vetëm si infrastrukturë për operatorët tjerë?

Muharrem Nitaj pyeti: Pse po vazhdojmë të marrim sms me 377, të na sqaroni të vërtetën për zbatimin e kodit 383?

Hykmete Bajrami, tha se keni deklaruar se licenca e Z Mobile nuk do të tërhiqet. Çka do të bëjë Z Mobile pas shkëputjes së kontratës me Telekomin? Çka do të ndodhë me numrat e telefonave mobilë që janë me Z Mobile? Lidhur me arbitrazhin e Telekomit me Z Mobile, a ju ka ftuar Telekomit të merrni pjesë në arbitrazh?

Memli Krasniqi, ju si rregullator, a mund të na shpjegoni se cilat janë kapacitetet për mbrojtje nga kërcënimet kibernetike dhe cilat mund të jenë pasojat nga sulmet kibernetike? Çka është duke ndodhur me procesin e digjitalizimit të transmetimeve radiodifuzive, ku gjendet ky proces? A ka koordinim me juve, si ARKEP dhe a keni analizuar se a është i nevojshëm procesi i digjitalizimit apo jo, pasi që rrjeti kabllor tashmë pothuajse ka arritur gjithkund? A mund ta shpjegoni më konkretisht se për çfarë shërbimesh apo punë nevojitet rritja e numrit të stafit pasi që është kërkesë e juaja përvitshme?

Kryetarja pyeti: A mund të zbatohet plani i punës me stafin ekzistues? A mund ta sqaroni deri në ç’ masë është implementuar kodi shtetëror telefonik 383? A ka ende operatorë ilegalë? Lidhur me ankesat e konsumatorëve, cila ka qenë natyra e ankesave, ndaj cilëve operatorë kanë qenë ankesat dhe në favor të cilës palë janë nxjerrë udhëzimet nga ARKEP? Ligjet në fuqi, a paraqesin ndonjë pengesë në zbatim të detyrimeve ligjore të ARKEP-it dhe të rregullimit të fushës së shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare?

Kreshnik Gashi (ARKEP)- tha se pyetjeve do t’u përgjigjem ashtu siç janë bërë, në mënyrë kronologjike. Po filloj me përgjigjet në pyetjet e deputetit z. Konjufca. Më duhet të them që raporti i punës së ARKEP-it i përmban të gjitha karakteristikat që i kërkon ligji për komunikimet elektronike dhe jo vetëm kaq, është një raport i punës, i cili është i ngjashëm me karakteristika identike të gjithë rregullatorëve të komunikimeve elektronike në Evropë. Pra, mund ta merrni secilin rregullator të Evropës dhe t’i shikoni karakteristikat dhe të shihni si janë

pasqyruar ato në këtë raport, beso që duhet t'i gëzohemi fakteve, nëse ka lëvizje pozitive në tregje të ndryshme, qoftë në tregun e internetit, qoftë në tregun e komunikimeve elektronike dhe besoj që të gjithë jemi të kënaqur kur ka lëvizje pozitive në atë drejtim, siç na shqetësojnë problemet, por duhet të identifikohen edhe problemet se ku e kanë adresën e tyre dhe cila është zgjidhja për to. Pra, duhet ta bëjmë një dallim të qartë ndërmjet rregullatorit dhe menaxherit të kompanive publike. Në shumë raste, kërkohet nga ne, si rregullator i komunikimeve elektronike, vetëm pse e kemi të shkruar komunikime elektronike ose Telekomini, të mbikëqyrim çdo operim edhe të ndërmarrjeve, qoftë publike, qoftë private apo lëvizjet dhe e raportet komerciale mes tyre. Po, e kam thënë, sepse ju referuat komisionit hetimor për Telekomini dhe Valën. E kam thënë edhe atë ditë, po e them edhe tash, nuk është çështje e menaxhimit të ARKEP-it. Ndërmarrjet publike nuk bien në menaxhim të rregullatorëve, asnjëherë. Rregullatori duhet t'i trajtojë ndërmarrjet, si publike, ashtu edhe private, në mënyrë të barabartë, për atë arsye se në bazë të ligjit është krijuar rregullatori. Problemet kryesore janë bartur te qytetari i Kosovës. Ne, gjatë mandatit tim, asnjë kërkesë të Telekomit të Kosovës nuk e kemi refuzuar, përveç njëres dhe ajo ka qenë për të ndaluar VIBER-in. Kjo ka qenë kërkesë fatkeqësisht edhe e IPKO-s, por duke u thirrur në atë se duhet të mbrojmë të drejtën e qytetarit, nuk i kemi lejuar, sepse komunikimi elektronik ekziston që t'iu mundësojë qytetarëve komunikim më të lehtë dhe më të lirë. Brenga jonë nuk është kur ka telefoni të lirë, brenga ekziston për një ndërmarrje publike, për të cilën kemi ndjesi të gjithë, por kemi edhe përgjegjësi të ndryshme, në raport me atë dhe në raport me përgjegjësitë tona, mund të bëhen edhe pyetjet dhe jo vetëm se ekziston një problem mes Telekomit dhe Z Mobile. -A ka ekzistuar ky problem edhe më herët, a ekziston tash apo a do të ekzistoj edhe në të ardhmen? Është çështje e tyre sesi do ta zgjidhin. Nëse ata vijnë te ne me një kërkesë të ligjshme, ne do ta trajtojmë apo nëse ata do të vijnë te ju me një kërkesë, atëherë edhe ju sigurisht që do t'i mbështesni, por ne nuk mund të ndërhyjmë në punët e tyre, vetëm duke dëgjuar në media se ka probleme. Realisht për gjendjen në Telekomini e Kosovës jemi të gjithë të brengosur, mirëpo kjo nuk e reflekton pasqyrën e tregut të komunikimeve elektronike, në përgjithësi, sepse Telekomini i Kosovës ka një numër të madh të konsumatorëve. Ata kanë vazhduar të operojnë në tregun e komunikimeve elektronike në vitin 2018 me 50% të tregut, kanë vazhduar të kenë të hyra të konsiderueshme, por në atë treg ka edhe probleme që janë evidente dhe duhet të gjithë të japim kontributin që t'i zgjidhim, mirëpo nuk mund të përzihet roli rregullatorit në rolin e operatorit. Ju kërkoni nga ne të bëjmë shkelje ligjore, nëse kërkoni të përzihemi në çështjet e operimeve të operatorëve. Ndërsa, në pyetjen e znj. Bajrami, e kam thënë në komision hetimor, po e them prapë, nuk ekziston më regjimi i licencave në Republikën e Kosovës, që nga viti 2012, me miratimin e Ligjit për komunikime elektronike, që nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ekziston regjimi i autorizimit të përgjithshëm. Ky regjim u jepet secilit që e kërkon, mjafton të regjistrohen në zyrën e ARBK në MTI dhe me aktivitetin e biznesit, Telekomini ka të drejtë të hyjë në regjistër, sepse kështu e thotë ligji. Nuk do të thotë që në mënyrë obliguese ai do të ketë të drejtë të operojë. Janë rreth 130 ose 140 operatorë aktivë në regjistrat e ARKEP-it, të cilët kanë karakteristika të ngjashme me DARDAFON dhe me disa të tjerë, por jo të gjithë janë MVNO, shumë nga ta nuk operojnë hiç e shumë tjerë operojnë vetëm në atë që quhet VAS, ku dërgojnë SMS të caktuar, në bashkëpunim me operatorë. Prandaj, çështja nuk është aq e thjeshtë, mbaroi licenca dhe hiqe nga ARKEP-i, për shkak se ne nuk mund të bëjmë shkelje ligjore, në raport me operatorët. Edhe ne shpesh sfidohehi nga operatorët, mirëpo deri më tani i kemi fituar të gjitha rastet, që i kemi pasur me operatorët, por e dhe rastet në raport me rregullatorin janë të shumta. Ndërsa për pyetjen në lidhje me arbitrazhin, ne nuk jemi ftuar nga Telekomini, që të jemi pjesë e

arbitrazhit dhe nuk jemi ftuar me të drejtë, sepse në bazë të ligjit për komunikime elektronike, nëse dy operatorë ngritin një çështje në gjykatë, nuk ka të drejtë rregullatori, përkatësisht ARKEPI të ndërhyjë. Në pyetjen se a është Z Mobile MVNO, po është MVNO Z Mobile, mund të pyesni se çfarë MVNO-je është.

Glauk Konjufca, pyeti: Z Mobile është MVNO, që ta shkatërrojë atë kompani që e ndihmon, a po?

Kreshnik Gashi (ARKEP)- Nëse është duke ndodhur kështu, atëherë është fatkeqësia më e madhe për Telekomin e Kosovës. Ne e dimë që ka probleme të mëdha mes Z Mobile dhe Telekomit të Kosovës, por MVNO-të, parimisht nuk janë për të shkatërruar operatorët, sepse ata me vullnet, pra Telekom i Kosovës ka hyrë në një marrëveshje të tillë dhe nuk mund të mbyllim në një operator, nëse ka probleme me një operator tjetër, në parim është kështu.

Glauk Konjufca- Por ju i bëni rregullat për të operuar?

Kreshnik Gashi (ARKEP)- Rregullat i ka përgatitur ligji dhe ka lejuar liberalizimin e tregut dhe e ka lejuar secilin që të hyjë në operime virtuale, mjafton ta kenë një kontratë.

Glauk Konjufca- Nuk ka askund në botë një MVNO të tillë, që e shkatërron kompaninë me të cilën lidh marrëveshje. Ato duhet ta ndihmojnë njëra-tjetrën, ndërsa këtu ia merr klientët dhe në raportin tuaj nuk e keni thënë asnjë fjalë për Z Mobile. Pse nuk e keni potencuar që e ka shkatërruar tregun?

Kreshnik Gashi (ARKEP)- Tregu në Republikën e Kosovës nuk është shkatërruar. Realisht, ka oferta dhe çmime të ndryshme për qytetarët e Kosovës dhe Telekomin duhet ta gjejë një zgjidhje dhe nuk është problematika aq e madhe sa mundohet. Shpesh të polemizojnë, për ta bërë çështje politike, por megjithatë është çështje e tyre. Ne nuk mund të ndërhyjmë në operimet e Telekomit të Kosovës.

Rrezarta Ajeti (ARKEP)- Dua të përgjigjem në pyetjen e deputetit Konjufca, a është e kundërligjshme apo jo? Unë konsideroj se kur nuk ka bazë ligjore apo kur nuk përfillen kriteret në bazë të ligjit për transferim të licencës, ligji i cili ka qenë në fuqi në atë kohë, ligji për telekomunikacion, neni 26 e ka paraparë mundësinë e transferimit të licencës, në mënyrën identike është transferuar, para kësaj, licenca e kujtesës, d.m.th. nuk ka pasur asnjë problem. Objekt i trajtimit në gjykata janë vendimet e ARKEP-it. Ne asnjëherë nuk e kemi pranuar asnjë padi lidhur me vendimin, të cilin e kemi marrë, për të thënë që vendimi është i kundërligjshëm, atëherë duhet të jetë një vendim i plotfuqishëm i gjykatës për çështjet administrative. Sa i përket shkatërrimit që ju po e përmendeni, së pari duhet të konstatohet që MVNO-ja e ka shkatërruar Telekomin, qysh kemi ardhur deri te MVNO-ja? ARKEP-i nuk i ka marrë vendimet vetë, i zbaton çdo vit politikat e sektorit për telekomunikacion, atëherë, ndërsa tash politikat për komunikime elektronike, si kërkesë e politikave të sektorit në atë kohë, është hapja e tregut e cila për së paku edhe për një MVNO, e cila është edhe kërkesë e BE-së, krejt veprimet që janë ndërmarrë nga ARKEP-i, janë ndërmarrë në përputhje me rregullatorin ligjor. Ju thatë që, a bën rregullatori vetëm analiza? Ne normalisht e kemi kapitullin për analiza të tregut, por çka del nga ato analiza, dalin si obligime për rregullatorin, sikur na vetëm të kishim bërë analiza dhe mos të

kishim rregulluar tregun, sot do ta kishim vetëm një ndërmarrje e cila kishte pasur monopolin. Sot, nëse ne flasim për kualitet të mirë ose të keq, ose për çmime më të mira, krejt është falë rregullatorit, i cili e ka hapur tregun. Sa i përket a kemi kërkesa për hyrësit e rinj në treg, këta hyrësit e rinj në treg, me ndryshimin e Ligjit për komunikime elektronike, është liberalizuar përfundimisht tregu dhe janë hequr barrierat, të cilat kanë qenë me licenca. Tani është autorizimi i përgjithshëm, me këtë autorizim, gjithkush mundet veç ta bëjë një tik dhe të ofrojë shërbime. Çështja tjetër, vjen kur ka të bëjë me përdorimin e resurseve të kufizuara d.m.th. me numra dhe me frekuenca, krejt operatorët, pra a është MVNO apo jo. MVNO-ja nuk i ka frekuencat e veta. Ajo i përdor frekuencat e tjerëve, por kemi edhe shumë kontrata tjera, për shembull janë kodet e shkurtra me 5 (pesë). Asnjëri nga ta nuk e kanë infrastrukturën e tyre, krejt e përdorin të operatorëve të rrjetit, ku janë me qindra kontrata që lidhen. Ne, asnjëherë, nuk ndërhyjmë në raportet komerciale mes operatoreve, sepse nuk është çështje e ARKEP-it. Sa i përket hapjes së tregut, faza e parë, të cilën jemi duke e bërë këtë vit, është riautorizimi i frekuencave për operatorët ekzistues, Telekom i Kosovës dhe IPKO. Telekom i Kosovës i skadojnë frekuencat më 30 korrik, kurse IPKO-s rreth dy muaj më vonë e disa në vitin 2020. Aktualisht, ARKEP-i ka qenë i zënë me këtë proces. Faza e dytë është hapja e tregut, kur ne e bëjmë një thirrje që jemi duke hapur breze tjera, të cilat nuk i kemi ndarë deri tash. Atëherë, ne presim interesim nga operatorët se a ka dikush interesim që të marrë frekuenca, ndërsa sa i përket brezit aktual, janë duke i riautorizuar të njëjtat. Me ligj, parashihen se cilat breze janë me rëndësi të posaçme ekonomike, d.m.th. brezi 800, 900, 1800 dhe 2100, janë breze me fuqi të posaçme ekonomike. D.m.th. ne e bëjmë vlerësimin, kur nuk ka të zëna. Pra, ato që janë të lira, hapen dhe atëherë ata që janë të interesuar, ajo shkon në bazë të ligjit dhe procedurave të tjera, nëpërmjet tenderit apo nëpërmjet ankandit, varësisht sesi vendos rregullatori. Nëse bëhet përmes tenderit, atëherë rregullat i cakton ministria përkatëse, ndërsa nëse bëhet përmes ankandit, rregullat i cakton ARKEP-i.

Lutfi Zharku pyeti: Nëse në mënyrë hipotetike themi, a ka mundësi që t'i kemi 10 operatorë?

Rrezarta Ajeti (ARKEP), nuk ka brez të mjaftueshme për 10 operatorë, sepse edhe në vendet tjera, brezi është i kufizuar d.m.th. brezi që është me fuqi të posaçme ekonomike.

Kreshnik Gashi (ARKEP)- Ne kemi pasur një vizitë nga kryetarja e komisionit dhe z. Nitaj në ARKEP dhe kemi bërë një raport në lidhje me zbatimin e kodit 383, ndërkohë kemi bërë raporte të rregullta edhe për nevojat e Qeverisë, lidhur me zbatimin e kodit dhe fatkeqësisht situata nuk qëndron mirë, kryesisht me Telekomin e Kosovës, për shkak se ajo që tha z. Nitaj, Telekom i Kosovës e ka bërë ndërrimin e kodit vetëm në mënyrë virtuale dhe në esencë nuk i ka bërë ndryshimet e nevojshme në centralet e tyre, për të përfituar nga zbatimi i kodit 383 dhe rezultat kryesisht gjatë përdorimit të romingut, ose dërgimit të sms-ve, mund të pranojmë sms me 377 ose mund të dërgohen thirrje me kodin 377.

Muharrem Nitaj pyeti: Derisa Telekom i Kosovës nuk i ka kryer operacionet e nevojshme për funksionalizimin e kodit të ri, a vazhdon Telekom i Kosovës të paguajë para të majme në emër të shfrytëzimit të një kodi tjetër dhe a mund të ketë ndonjë dallavere, që qëllimisht mos të funksionalizohet kodi shtetëror i Kosovës, në mënyrë që dikush të përfitojë nga paratë që jepen në emër të shfrytëzimit të kodeve tjera dhe a mund të konstatohet që ky është një mashtrim ordiner?

Kreshnik Gashi (ARKEP) - tha se me moszbatimin e kodit, humb Telekom i Kosovës, sepse ata shfrytëzojnë një kod të huaj, në këtë rast kodin e Monakos. Ne nuk e dimë shumë se sa janë humbjet, sepse është kontratë komerciale dhe ne nuk e dimë, sepse jemi palë dhe ata kanë pasur raporte të ndryshme me Monakon dhe ky mund të jetë një problem. Duhet të pyetet menaxhmenti i Telekomit, por edhe në qoftë se një cent më shumë harxhohet në thirrje, për shkak të mospërdorimit të kodit telefonik 383, atëherë është dëm që i shkaktohet Republikës së Kosovës, përkatësisht Telekomit, nëpërmjet saj edhe qytetarëve të Kosovës. Ata kanë zbatuar vetëm një fazë të parë të implementimit të kodit 383. kjo nuk d.m.th. që i ka mashtruar qytetarët. Por faza e parë e zbatimit të kodit ka qenë largimi i kodeve, si fillim i testimit të përdorimit të kodit, përdorimi vetëm i kodit 383 në thirrje ndërkombëtare, por që ju ka dhënë mundësi operatorëve, që t'i bëjnë ndryshimet në centralet e tyre dhe operatori Telekom i Kosovës, është i njohur me të gjitha afatet kohore. ARKEP nuk ka mundësi të marrë veprime tjera, i ka gjobitur operatorët edhe Telekomin, edhe IPKON dhe të tjerët, që nuk e kanë zbatuar kodin e ri. Sa i përket pyetjes së z. Krasniqi, kjo temë është shumë më rendësi, siguria kibernetike dhe mungesa e resurseve të nevojshme adekuate, e cila lidhet edhe me pyetjen e kryetares në lidhje me stafin. Unë mund t'iu them që janë rreth 4-5 projekte të ARKEPIT, por janë edhe disa procese, në të cilat është duke kaluar ARKEPI, për të cilën aktualisht nuk kemi staf të mjaftueshëm dhe në raste të caktuara duhet të bazohemi në ekspertizë nga jashtë.

Glauk Konjufca pyeti: A keni bërë ndonjëherë 3 thirrje rresht në Vala, pa të dështuar ndonjëherë?

Rrezarta Ajeti (ARKEP)- Po, i kam bërë dhe ndoshta ka ndodhur që ndonjë të dështojë dhe kjo është çështje e kualitetit të shërbimeve. Ne i paraqitëm sfidat tona. Pra, ne merremi edhe me ankesat e konsumatorëve dhe me këtë staf që e kemi është problem, sepse krejt rregullatorët kanë departamente të veçanta për mbrojtjen e konsumatorëve dhe ne japim maksimumin që t'iu përgjigjemi konsumatorëve, sepse na vjen keq, por stafi është shumë i vogël.

Hykmete Bajrami pyeti: Çka ndodh me bazën konsumatorë, çka ndodh me numrat të cilat i ka Z Mobile dhe në pronësi të kujt janë numrat? Sepse, në qoftë se i mbesin numrat që janë me qindra mijëra Z Mobile dhe në qoftë se ju i keni dhënë autorizimin, ata nuk kanë nevojë fare që të kryejnë shërbime më për Telekomin, sepse e kanë bazën e konsumatorëve dhe vazhdojnë të operojnë.

Kreshnik Gashi (ARKEP)- Operimi i telefonisë mobile funksionon në atë formë, që shteti i jep frekuencat me vlerë të posaçme ekonomike. Në Kosovë janë dy operatorë, Telekom i Kosovës dhe IPKO. Vetëm këta dy operatorë kanë frekuenca në dispozicion, për të ofruar rrjetin e komunikimeve elektronike nëpërmjet antenave, që zhvillohet dhe nuk i nevojitet asnjë operatori nëse nuk ka kontratë valide me një operator të rrjetit.

Pas diskutimeve, komisioni, me 4 (katër) vota për dhe 3 (tri) kundër, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti vjetor i Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2018.

5. Të ndryshme
Çështjet vijuese

Kryetarja njoftoi deputetët se gjatë javës, do të organizohet një vizitë mbikëqyrëse e Komisionit në Autoritetin e Aviacionit Civil, në Agjencinë për Shërbimet e Navigacionit Ajror dhe në aeroport, i ftoi deputetët të marrin pjesë në këtë vizitë mbikëqyrëse.

Propozimi u përkrah nga komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA